

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE
“2EBXH” sh.p.k

Elbasan më datë 19/04/2018.

NENI 1

Shoqëria Tregtare “2EBXH” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

NENI 2 - EMRI I SHOQËRISË

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “2EBXH” sh.p.k.

NENI 3 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të mëposhtme:

Ngritja dhe organizimi i funksionimit të parkimeve. Projektimi, financimi, testimi, venia në punë, operimi e mirembajtja e parkimeve. Administrim parkimi me pagese, mbledhje e tarifave perkatese nga perdoruesit. Çdo veprimtari tjetër që lidhet me administrimin, organizimin dhe funksionimin e parkimeve.

Sherbime mbikqyrje, administrimi, ndihmese në fushën e parkimit me pagese të mjeteve motorrike në rrugë ose në zonat e caktuara për parkim me pagese, sherbime në fushën e ndertimit, bashkëpunimi me subjektet e treta për ushtrim veprimtarie në sherbimin me pagese, shërbime pastrimi, gjelbërimi, lavanderi, catering,hoteleri.

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpermendur, Shoqëria mund: të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhenie-marrje me qera, të vendosë pengje dhe barre hipotekore; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara me sipër dhe nuk bien në kundërshtim me objektin e veprimtarisë; të blejë në mënyrë direkte apo indirekte, kuota të shoqërive të tjera që kanë një objekt të përafërt me atë të Shoqërisë, në Shqipëri ose jashtë shtetit; të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i domosdoshëm për të arritur qëllimin e aktivitetit të saj. Shoqëria duhet të kryejë çdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj, në lidhje dhe që e favorizon atë.

Kryerjen e çdo operacioni ekonomik e juridik, shërbimesh, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, për të cilin, në bazë të legjislacionit shqiptar, kërkohet leje e posaçme nga organet kompetente të administratës publike.



NENI 4 - SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagjia "Kongresi i Elbasanit", Rr. "Bulevardi Qemal Stafa", Pall.53, Elbasan.

NENI 5 - KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100 (njëqind) lekë. Kapitali ndahet në 1 pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. **Eltjon Bodinaku**, i biri i Fatos-it, lindur në Tiranë më 26.04.1989, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033495780, dhe nr. Personal I90426070B, zotëron 100% të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej 100 (njëqind) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

NENI 6 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7 - ORGANET DREJTUESE

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është **Evangeljeli Xhuvani**, e bija e Pjerin-it, lindur në Tiranë më 10.06.1995, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 031926647 dhe nr. Personal J55610098M, me adresë: Lagjia "Luigj Gurakuqi", Pall. 54, Hyrja A, Apartamenti 12, Elbasan, person madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar me një afat emërimi prej 5(pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.



NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tirane.

NENI 13 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Akt i Themelimit hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES

(emër, mbiemër, nënshkrimi)

Elton Bodinaku

